

## Vendim nr. 217 datë 02.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 02.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** FLAMUR KALIVAÇI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 899 akti, datë 18.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2348, datë 07.11.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-400, datë 07.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe vëllai i tij, B.K., me vendimin nr. 3679, datë 03.05.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë themeluar shoqërinë tregtare “BBF” sh.a., e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj median vizive, organizimin e koncerteve, TV, radio, prodhime audio e

video etj. dhe në të cilën secili prej tyre ka 50% të vlerës së aksioneve, për rrjedhojë edhe të votave në Asamblesë të Përgjithshme. Sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të kohës (sot “Qendra Kombëtare e Biznesit”), që një vendim i shoqërisë të regjistruar në QKR duhej të plotësohej kuorumi i nevojshëm i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve për marrjen e tij, i cili duhej të ishte  $\frac{3}{4}$  e votave të aksionerëve, me përjashtim të rasteve kur statuti parashikonte një shumicë më të lartë. Si rrjedhojë e mosdakordësive mes dy aksionerëve, kjo vendimmarrje ka qenë e pamundur.

2. Duke pretenduar, ndër të tjera, se në kundërshtim me ligjin QKR-ja kishte regjistruar vendime të Asamblesë së Përgjithshme të marra vetëm nga aksioneri tjetër, ndërsa nuk kishte pranuar të regjistronte, në të njëjtat kushte, vendimet e marra prej tij, në datën 24.03.2016 kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria Tiranë*) për kryerjen nga punonjësit e këtij institucioni të veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal (*KP*).

3. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, në mbështetje të nenit 290, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), Prokuroria Tiranë ka disponuar me mosfillimin e procedimit penal, duke vlerësuar se fakti i kallëzuar nuk përbënte vepër penale.

4. Kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 899 akti, datë 18.11.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se ndonëse pretendimet e kërkuesit se vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve ishin marrë në kundërshtim me ligjin ishin të bazuara, vlerësimi nëse faktet e pretenduara prej tij përbënin shkelje të karakterit administrativ ose vepër penale nuk ishin në diskrecionin e saj. Për më tepër, ajo nuk mund të detyronte organin e akuzës për të filluar çështjen penale, pasi ky mbetet atribut kushtetues i këtij organi. Qëndrimi i gjykatës mbështetej edhe në vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

5. Kërkuesi ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, për të cilin, me vendimin nr. 2348, datë 07.11.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se pretendimet e kërkuesit ishin të pabazuara.

6. Për rekursin e paraqitur nga kërkuesi, me vendimin nr. 00-2024-400, datë 07.03.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin, duke çmuar, ndër të tjera, se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohej shkaqeve të parashikuara

në nenin 432 të KPP-së. Kështu, në rekurs kërkuesi ngrinte pretendime për mënyrën e vlerësimit të provave/akteve nga punonjësit e QKR-së dhe nëse vendimi i prokurorisë ishte i drejtë ose jo, çka dilte jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Po sipas kolegjit, gjykatat i kishin arsyetuar vendimet e tyre në lidhje me veprimet dhe qëndrimin e mbajtur nga prokurori.

7. Në datën 05.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.07.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, pasi:

8.1.1. Prokuroria Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se nuk janë konstatuar shkelje ligjore, ndërkohë që nuk ka kryer asnjë veprim hetimor ose veprime paraprake, pavarësisht pretendimeve dhe sqarimeve të kërkuesit.

8.1.2. Ndonëse ka evidentuar shkeljet e punonjësve të QKR-së, gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e kërkesës me qëndrimin se nuk mund të shprehej nëse veprimet e këtyre punonjësve përbënin kundërvajtje administrative ose vepër penale, çka nuk i ishte kërkuar. Gjykatës i ishte kërkuar rikthimi i dosjes në prokurori, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve nëse shkeljet ligjore përbënin ose jo vepër penale. Në kushtet kur gjykatat kanë pranuar shkeljet e kryera, ato duhet të kishin urdhëruar prokurorinë për hetimin e tyre.

8.2. *E drejta e pronës*, pasi për shkak të moshetimit të çështjes shoqëria vazhdon të marrë vendime në kundërshtim me ligjin dhe t'i regjistrojë ato në QKB, duke ligjëruar aksionerin tjetër, në humbje të vlerës së aksioneve të kërkuesit e në dëm të interesave të tij. Ai është përjashtuar nga përfitimi i fitimeve të shoqërisë, të cilat gjatë pandemisë kanë kapur vlerën neto prej 1 milion eurosh, ndërsa aktualisht kapin vlerën 4 milionë euro në vit, duke i shkaktuar dëm ekonomik të paktën në vlerën e 10 milionë eurove.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që përpara se t’i drejtohet Gjykatës kërkuari duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës së pronës, e drejtë kjo me natyrë civile, ndërkohë që pretendimet e tij për procesin e rregullt ligjor ngrihen në drejtim të vendimmartjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që kanë vendosur në lidhje me ankimin e tij ndaj vendimit të Prokurorisë Tiranë për mosfillimin e procedimit penal. Në kushtet kur nga materialet e

depozituara me kërkesën nuk rezulton që në lidhje me pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës kërkuesi t'u jetë drejtuar më parë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vlerëson se për sa i përket këtij pretendimi ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

13. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-mujaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i fundit në kohë që ka përmbyllur procesin penal të iniciuar nga kërkuesi është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 07.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual i është dërguar Gjykatës në datën 05.07.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materia*, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, pretendim i cili *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues. Në lidhje me të Kolegji konstaton se, në thelb, ai ka të bëjë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimin e zbatimin e ligjit nga prokuroria dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor ngrihen si ndaj vendimit të Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal, ashtu edhe vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme që kanë vlerësuar të drejtë këtë vendimmarrje. Natyra e tyre rezulton të jetë tërësisht ligjore dhe argumentet e parashtruara nuk rezultojnë me përmbajtje kushtetuese, pra nuk ngrihen në drejtim të cenimit të të drejtave konkrete të garantuara nga Kushtetuta. Në këto kushte, Kolegji

vlerëson se ato nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit të Gjykatës, pasi nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e saj. Për më tepër, zbatimi i ligjit në rastin e tij nuk rezulton të ketë qenë arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor janë haptazi të pabazuara.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.